



<http://www.77news.al/index.php?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=11317>

## **Burrel, Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, merr pjesë në inagurimin e bustit të Dëshmorit të Atdheut "Shahin Toçi"!**

Përmes një aktivitetit të veçantë të zhvilluar në qytetin e Burrelit, u bë ceremonia e vendosjes së bustit të të Dëshmorit të Atdheut "Shahin Toçi" i cili dha jetën për flamurin tonë kombëtar. Shahin Toçi, bir i Urxallës së Derjanit, nuk u betua për flamurin Italian që iu kërkuar nga autoritetet vendase gjatë kohës kur ai studionte në shtetin fqinj, dhe kjo gjë i kushtoi jetën. Vepra e "Shahin Toçi" njihet për atdhetarinë e tij, "Kjo Shqipni ka lindur burra, që nuk njohin dy flamura". Në këtë aktivitet, Kryetarja e Bashkisë Burrel, Adelina Farrici, shprehu krenarinë e saj për figurën e Shahin Toçi-t, për veprën dhe mesazhin që ai la pas. Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Arben Imami, tha se duhet vlerësuar në maksimum kontributi i dhënë nga figura të shquara historike dhe atdhetare si "Shahin Toçi". Gjithashtu, ai tha më tej, se ato janë shembull për të gjithë shqiptarët dhe duhet të udhëhiqemi nga patriotizmi dhe dhënia e kontributit për të ardhmen e vendit. Në fjalën e tij Shahin Toçi i riu, nipi i heroit kombëtar "Shahin Toçi", falenderoi të gjithë ata që kontribuan në rikthimin e eshtrave dhe lartësimin e figurës së xhaxhait të tij duke vendosur bustin në zemër të qytetit të Burrelit. Kryetarja e Bashkisë Burrel, Adelina Farrici dhe Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, zbuluan bustin e Heroit Kombëtar, "Shahin Toçi" i cili do të qëndrojë në mesin e matjanëve gjithmonë. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe artist e muzikant të njohur nga disa treva të vendit, ku mes tyre spikati Artisti i Merituar, Reshat Arbana. Mijëra qytetarë të Burrelit ndoqën nga afër këtë aktivitet të veçantë. Por kush ishte Shahin Toçi dhe cili është akti heroik i tij?

Patrioti i madh shqiptar Shahin Toci lindi më 15 Prill të vitit 1914 në fshatin Urxallë të Matit në një familje të thjeshtë, bujare dhe të besës, ku brez pas brezi në këtë familje u trashëguan vlera të patriotizmit të vërtetë. Stërgjyshi dhe gjyshi i dëshmorit, Bajram dhe Stafë Toçi ishin ndër prijësit e lëvizjes popullore kundër pushtuesve osmanë dhe atyre serbo-malazezë. Në Tetor të vitit 1934 student i dalluar dhe i përkushtuar i Shkollës Ushtarake Mbretërore nis studimet në Kolegjin Ushtarak të Napolit, në Itali. Gjatë kohës së studimeve, Shahin Toçi iu përkushtua jo vetëm formimit ushtarak, por edhe studimeve nga lëndë të ndryshme. Sipas dëshmimeve dhe kujtimeve të familjes së tij, dëshmori Toçi gjatë kohës tre vjeçare të studimit në kolegjin Ushtarak të Napolit, iu përkushtua edhe përvetësimit cilësor të gjuhës italiane dhe franceze. Kohën e lirë ai e kalonte në Bibliotekën Kombëtare të Napolit dhe atë të shkollës. Ndërsa në korrik të vitit 1937, Shahin Toçi kthehet në Shqipëri. Përpjekjet e tij për tu arsimuar nuk përfundojnë këtu, pasi në tetor të vitit 1937 atij iu dha përsëri e drejta për kryerjen e studimeve akademike në Modena. Pas përfundimit me sukses të vitit akademik 1937-1938 ai diplomohet në Akademinë e Këmbërorisë dhe Kavalerisë së Modenas. Përgatitja e Shahin Toçit gjatë ndjekjes së këtyre studimeve u bë një shembull për gjithë studentët e tjerë. Dëshmori kthehet përsëri në atdhe, ku punon për një periudhë të shkurtër në Ministrinë e Mbrojtjes. Koha e shkurtër në këtë institucion lidhet me faktin se ai përsëri do të nisej për në Itali për specializim pas akademik. Oficeri Shahin Toci do të vendosej në një bujtine në rrugën Trans –Tevere nr. 45. Pushtimi italian oficerin Shahin Toci do ta gjente në Itali, për ndjekjen e studimeve pas akademike. Në këto kushte Shahin Toci doli hapur kundër këtij pushtimi, duke iu kërkuar edhe kolegeve të tij të kthehen në atdhe për të luftuar kundër Italisë fashiste. Por strukturat e larta të pushtetit fashist në Itali kishin arritur të kuptonin kundërshtimin e hapur të Shahin Tocit dhe kolegeve të tij dhe në këto mënyre ata do të viheshin nën një survejim të plotë. Dhe në këto situata fashistet filluan përpjekjet për të mos lejuar revoltimin e metejshëm të oficerëve shqiptarë pas pushtimit të vendit nga. Në fillim të muajit maj, një nga këto përpjekje sidomos të drejtuesve të shkollave ushtarake ishte edhe përgatitja e ceremonive për betimin para flamurit italian. Kjo nisme ishte e përgatitur me kujdes sidomos nga Ministria e Luftës në Itali, duke patur si qëllim që të mposhtin revoltën e ushtarakeve dhe studentëve shqiptarë kundër pushtimit. Por Shahin Toci arriti të kuptonte qëllimet e vërteta të këtij betimi, të këtyre ceremonive. Në një nga ditët e muajit maj të vitit 1939, fill një muaj pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste nën kujdesin e nënkryetarit të shtetit për luftën u organizuar një ceremoni para betimit. Studenti shqiptar mbante edhe simbole kombëtare një shirit kuq e zi, duke sjell edhe revoltimin e organizatoreve të ceremonisë. Me pas kuadrot e larta ushtarake u thirrën perseri. Sipas programit, betimi do të bëhej në një nga sheshet e kryeqytetit italian, në datën 13 maj 1939. Ditën e betimit, para studentëve dhe oficerëve shqiptarë, njëri nga oficerët mëdhenj italianë lexoi formulën e betimit. Midis heshtjes që kishte përfshirë studentët dhe oficerët shqiptarë, degjohet të flase Shahin Toci, duke shprehur se: Zoti gjeneral, në jemi shqiptarë dhe mund të betohemi vetëm para flamurit kuq e zi.

Oficeri shqiptar nga Mati vazhdoi akoma të fliste në mbrojtje të flamurit dhe interesave të Shqipërisë. Në këto mënyre nuk u realizua edhe plani i ushtarakeve italiane për të pasur mbështetjen e oficerëve

shqiptare për pushtimin e Shqipërisë. Por ky akt i lartë patriotik, do të kushtonte jetën e oficerit të shkelqyer shqiptar. Pas këtij qëndrimi, ai do të vihej nën një survejim të plotë, duke u parë si një kërcënim serioz për pushtuesit si në Itali ashtu edhe nëse kthehej në Shqipëri. Edhe pse oficeri shqiptar Shahin Toçi e kishte kuptuar që këto qëndrime ishin të rrezikshme për jetën e tij, ai perseri nuk ishte ndalur për mbrojtjen e interesave të Shqipërisë. Pas gjithë këtyre zhvillimeve që kishin ndodhur Shahin Toçi më 25 maj 1939 u gjend i vrarë në rrugën Trastevere në Romë, i cili pak ditë më parë kishte refuzuar të bente betimin fashist në Akademinë Ushtarake.

Nga Dritan Kurti



